

# KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË OFERTËS

## 1. PËRKUFIZIME

Garantuesi: Shoqëria e Sigurimeve "ANSIG SH.A."

Kontraktuesi: Subjekti, që nënshkruan Kontratën e Sigurimit të Garancisë.

Përfituesi: Enti Prokurues (interesi pasuror i të cilit sigurohet nga "Çertifikata e Garancisë së Ofertës".

## 2. OBJEKTI I KONTRATËS

2.1. Garantuesi i detyrohet Përfituesit deri në shumën e sigurimit të përcaktuar në kontratë nëse Kontraktuesi, pjesëmarrës në tender:

2.1.1. Tërhiqet nga oferta pas afatit për paraqitjen e ofertave;

2.1.2. Megjithëse është fitues i tenderit nuk lidh kontratën për të cilën është zhvilluar tenderi me Përfituesin në afatin e parashikuar në ofertë;

2.1.3. Megjithëse fituesi i tenderit nuk depoziton "Çertifikatën e Garancisë së Ofertës".

## 3. PERIUDHA E GARANCISË

Periudha e mbulimit do të jetë :

3.1. Data e fillimit, jo më vonë se dita e caktuar për zhvillimin e procedurës së tenderit;

3.2. Data e mbarimit është dita kur zhvillohet dhe përfundon procedura e tenderimit;

3.3. Kjo kontratë garancie do të mbetet në fuqi, në rast se Përfituesi shtyn datën e zhvillimit të tenderit, kundrejt paraqitjes së një deklarate me shkrim nga Kontraktuesi;

3.4. Vlefshmëria e kontratës fillon në afatet e përcaktuara nga Njësia e Prokurimit për lidhjen e kontratës.

## 4. SHUMA E SIGURIMIT

4.1. Garantuesi i detyrohet Përfituesit, deri në shumën e sigurimit, të përcaktuar në këtë kontratë.

## 5. PRIMI I SIGURIMIT

5.1. Primi i sigurimit llogaritet nga Garantuesi sipas "Sistemit tarifor për kontratat e garantimit të ofertës dhe kontratës"

5.2. Pagesa e primit do të kryhet një kohësisht me lidhjen e kësaj kontrate.

## 6. NJOFTIMI I RASTIT TË SIGURIMIT

6.1. Përfituesi duhet të njoftojë Garantuesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit.

6.2. Në rast se Përfituesi nuk respekton afatin, Garantuesi ka të drejtë të refuzojë për pagimin ose jo të dëmshpërblimit.

## 7. DËMSHPËRBLIMI

7.1. Garantuesi, do të paguajë për çdo kërkesë me shkrim të Përfituesit, sipas nenit 2 të kësaj kontrate, deri në shumën e sigurimit të përcaktuar në të.

7.2. Pagesa do të kryhet brenda një periudhe 15 ditore, pas kërkeses me shkrim të Përfituesit, ose të përfaqësuesit të autorizuar dhe kur të jetë plotësuar kushti sipas nenit 3 të kësaj kontrate.

## 8. DETYRIME TË PALEVE

Garantuesi ka detyrimin:

8.1. Të paguaj për llogari të Përfituesit çdo dëm kur është vërtetuar që ka ndodhur për faj të Kontraktuesit,

8.2. Të përfundojë kontratën e sipërmartjes ose ndonjë detyrim kontraktual i cili është i garantuar nga "Çertifikata e Garancisë së Ofertës".

## 9. ZGJIDHJA E KONTRATËS

9.1. Kontrata e Garancisë mund të anulohet, duke ia kthyer atë Garantuesit sëbashku me Çertifikatën e Garancisë së Ofertës.

9.2. Në rastin e anulimit të "Çertifikatës së Garancisë së Ofertës", Garantuesit i lind e drejta ti mbajë Kontraktuesit shpenzimet administrative në masën deri në 20 % të primit të arkëtuar.

9.3. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve që mund të lindin midis Garantuesit dhe Përfituesit, kompetente për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

SIGURUESI

KONTRAKTUESI